

## Përdoreni çdo ditë të jetë suaj sa më mirë të mundeni (Predikuesit 9, 10)

Në librin e Predikuesit, Salomoni arriti në përfundimin se gjëja më e mirë për një njeri është ta jetojë jetën çdo ditë ashtu siç i vjen dhe ta gëzojë atë ashtu siç ia jep Perëndia. Ai theksoi se Perëndia na jep gjithçka, jo vetëm jetën, por edhe aftësinë për të punuar si dhe mjetet me të cilat punojmë çdo ditë. Salomoni na këshillon që të jemi të kënaqur me çfarëdo që na sjell jeta. Ne duhet të gëzohemi kur kemi ditë të mira dhe të mësojmë nga ditët me hidhërimë. Ditët me hidhërimë mund të na ndihmojnë të mendojmë qartësisht dhe të ecim në drejtimin e duhur.

Meqenëse Perëndia është dhuruesi i gjithçkaje, ne duhet ta nderojmë Atë çdo ditë, me gjithçka që na jep. Asnjëri nuk mund të bëjë një jetë të plotë, pa nderuar Krijuesin e jetës. Njeriu pa Perëndinë nuk ka të ardhme. Ndonjëherë, fjalët e Salomonit duken pesimiste, megjithatë ato na mësojnë që të mendojmë dhe të veprojmë pozitivisht. Pesimizmi i tij ndoshta ishte reflektimi i gabimeve të tij në të kaluarën. Salomoni, jo vetëm që nxorri mësim nga gabimet e tij, por ai u përpoq që t'i paralajmëronte të tjerët për të mos bërë të njëjtat gabime. Përshkrimi i gabimeve të tij është ana negative e mësimin të Salomonit, kurse këshillat e tij për ne (si t'i evitojmë këto gabime) janë ana pozitive.

Te kapitujt 9 dhe 10, Salomoni fillon t'i japë formë konkluzionit të rëndësishëm të shkrimeve të tij. Duke u nisur nga fakti se jeta jonë mund të jetë shumë e shkurtër, ne duhet ta përdorim sa më mirë çdo ditë të jetës tonë. Salomoni thotë se realizimi i kësaj kërkon mençuri (kapitulli 9) dhe se vetëm pak marrëzi është e mjaftueshme për të shkatërruar efektet e mençurisë (kapitulli 10).

### **VDEKJA ËSHTË E SIGURTË (9:1–12)**

Perëndia i bekon të gjithë njerëzit njësoj. Lexojmë te 9:2: «Çdo gjë u ndodh në mënyrë të njëllotë të gjithëve: i njëjti fat pret të drejtin dhe të pabesin, të mirin, të pastrin dhe të papastrin, atë që ofron flijime dhe atë që nuk ofron. Si i miri është edhe mëkatari, dhe ai që betohet si ai që ka frikë të betohet.» Perëndia e dërgon shiun mbi të drejtin dhe mbi të padrejtin (Mateu 5:45). Nuk mund të dallojmë në qoftë se Perëndia mbështet jetën e një njeriu apo të një tjetri, duke parë të mirat që këta njerëz gëzojnë në tokë. Në qoftë se një njeri është i pasur, kjo nuk do të thotë me domosdo se Perëndia e përkrah këtë njeri. Dhe as tragjeditë në jetën e një njeriu nuk do të thonë se Perëndia është i pakënaqur me këtë njeri. Vështirësitë e jetës i provojnë si i miri ashtu edhe i keqi, si ata që e nderojnë Perëndinë, ashtu dhe ata që nuk e nderojnë. Vetëm një gjë është e sigurtë: Punët e njeriut të mirë dhe të mençur drejtohen nga dora e Perëndisë. Këto punë apo vepra të mira, që bën një njeri, nuk janë të pavlera për Perëndinë, edhe pse individët nuk shikojnë ndryshim në mënyrën se

si bota i trajton ata.

Asnjeri s'mund t'i shmanget vdekjes (9:3–6). Mund të duket e padrejtë që besimtarët kanë të njëjtin fund si jobesimtarët. Në qoftë se nuk i mbajmë sytë drejt të mirave të përjetshme, të premtuara për besimtarët e Perëndisë, atëherë do të zbulojmë pak të mira në të qenët besimtar. Disa mund të zgjedhin rrugë të keqe, sepse nuk shikojnë ndonjë avantazh në të qenët besimtar.

Salomoni tha: «Për deri sa njeriu është i bashkuar me gjithë të gjallët e tjerë ka shpresë, sepse një qen i gjallë vlen më tepër se një luan i ngordhur» (9:4). Në kohët antike, qeni konsiderohej si kafsha më e ulët në krahasim me gjithë kafshët e tjera. Qentë nuk përdorehin si kafshë shtëpiake, si përdoren sot. Luani ishte mbreti i kafshëve, i admiruar për kurajon dhe shpejtësinë e tij. Salomoni po thoshte: «Është më mirë që të mos jesh asgjë dhe të jesh i gjallë sesa të jesh diçka dhe të jesh i vdekur. Vetëm ata që janë të gjallë kanë shpresë për të mësuar apo për të arritur diçka gjatë kësaj jete.» Vargu 5 thotë: «Të gjallët në fakt e dinë se kanë për të vdekur, por të vdekurit nuk dinë gjë,...» (9:6). Çdo gjë që njeriu bën gjatë jetës së tij në tokë s'ka më asnjë vlerë kur ai vdes. Ai do të harrohet.

E kemi të vështirë të kuptojmë nëse Salomoni po fliste në këtë mënyrë sepse ishte i zhgënjyer nga jeta apo qëllimi i fjalëve të tij ishte të pasqyronte, ashtu siç ishte, situatën e jetës për ata njerëz që nuk besonin në Perëndi. Mënyra se si disa njerëz shprehen, madje edhe në ditët e sotme, tregon se ata nuk e njohin Perëndinë dhe nuk e kuptojnë jetën e përjetshme. Perëndia është një Perëndi i përjetshëm, jo thjesht vetëm Perëndia i atyre që jetojnë në tokë. Kur Perëndia iu shfaq Moisiut në ferrën që digjej (Eksodi 3:6), Ai tha: «Unë *jam* Perëndia i atit tënd, Perëndia i Abrahamit, Perëndia i Isakut dhe Perëndia i Jakobit.» Që të gjithë këta patriarkë kanë qenë të vdekur për shekuj, megjithatë Perëndia *është* (dhe jo *ishte*) Perëndia i tyre.

Sipas Salomonit, ne duhet ta jetojmë jetën me gëzim (9:7–12). Ne duhet të shijojmë frytet e punës tonë dhe të mbetemi të kënaqur me çfarë Perëndia na ka dhënë. Salomoni tha se duhet t'i përdorim bekimet tona për të nderuar Perëndinë ndërsa jemi gjallë dhe kjo është pikërisht ç'ka Perëndia pret prej nesh.

Salomoni, gjatë jetës së tij, nuk i praktikoi ato këshilla që na jep për sa u përket grave te 9:9. Ai

kishte shtatëqind gra, por ai duhet të ketë mësuar nga jeta e tij se plani i Perëndisë është më i miri për martesën. Perëndia në fillim krijoi një grua për një burrë. Ai toleroi martesat me më shumë se një grua po ashtu si divorcin dhe rimartesën, përpara ardhjes së Krishtit (Mateu 19:3–9), por Ai kurrë nuk qe i kënaqur me to. S'ka këshillë më të mirë se sa kjo që gjendet në Bibël: «Gëzoje jetën me gruan që do për të gjitha ditët e jetës tënde të kotësisë». Salomoni dha një këshillë të njëjtë te Fjalët e Urta 5:18–19: «...gëzohu me nusen e rinisë sate».

Më tej Salomoni këshilloi: «Tërë ato që dora jote gjen për të bërë, bëji me gjithë forcën;...» (9:10). Në qoftë se ia vlen që të bësh diçka, atëherë duhet ta bësh ashtu si duhet. Përsëri, forca që të motivon është të kuptuarit se çfarëdo që duhet të bësh duhet ta bësh në këtë jetë. Vargu 10 vazhdon: «...sepse në Sheol ku po shkon nuk ka më as punë, as mendim, as njohuri dhe as dituri».

Asnjëherë nuk mund ta dimë me saktësi se çfarë do të ndodhë në jetën tonë. Salomoni tha:

Gjithashtu pashë nën diell që vrapimi nuk fitohet nga ai që është i shpejtë as beteja nga të fortët; as buka nuk u shkon të urtëve, as pasuritë njerëzve të zgjuar, as favori atyre që janë të shkathët, por të gjithëve gjërat u ndodhin sipas kohës dhe rastësisë (9:11).

Jo gjithmonë fiton vrapuesi i shpejtë apo ushtari i fortë. I dituri nuk është gjithmonë njeriu që ha më mirë dhe as ai që gjithmonë pasurohet. Çdo njeri ballafaqohet me rrethana të vështira. Jeta ka shumë rreziqe dhe ne nuk mund ta dimë para kohe se çfarë rreziku na kanoset. Salomoni thotë se kjo është e njëjtë me një peshk që kapet me rrjetë apo me një zog që kapet në çark (9:12). Ndonjëherë fundi vjen papritur. Si rrjedhim, duhet të shfrytëzojmë çdo ditë sa më mirë që të mundemi, ndërkohë që e kemi atë.

### NEVOJA PËR MENÇURI (9:13–18)

Edhe pse mençuria nuk vlerësohet gjithmonë, ajo gjithmonë është dhurata më e mirë për një njeri. Te 9:14–16 tregohet se si një qytet i vogël u sulmua nga një mbret i madh. Mbreti rrethoi qytetin e vogël me ushtrinë e tij të fuqishme. Në qytet, një njeri i varfër por i ditur e dinte se çfarë duhej bërë për të shpëtuar qytetin nga rrethimi. Menjëherë, pasi shpëtoi qytetin, njeriu i varfër u harrua nga bashkë-qytetarët e tij. Vetëm njerëzit mosmirënjohës mund

ta harronin atë që bëri njeriu i ditur. Mosmirënjohja mund ta dëmtojë shumë një komb. Shumë projekte të dobishme shpërbëhen për arsye se nuk tregohet vlerësimi i duhur për ata që kanë punuar shumë në të kaluarën. Gjithashtu, njerëzit shpesh nuk e vlerësojnë mençurinë dhe diturinë e njëri-tjetrit. Edhe pse kjo është e vërtetë, mençuria prapë është superiore ndaj forcës.

Fjalët e qeta të një njeriu të zgjuar janë shumë më të fuqishme se të bërtiturat e një mbreti budalla (9:17). Mençuria dhe të kuptuarit janë më të fuqishme se çdo armë lufte, megjithatë një njeri i paskrupullt dhe mëkatar shkatërron një të mirë të madhe (9:18).

### **PASOJAT SHKATËRRUESE TË MARRËZISË (10:1–20)**

Duhet vetëm pak marrëzi për të shkatërruar të mirat e një dituria të madhe (10:1). Salomoni e shpjegon këtë duke thënë se disa miza të ngordhura e qelbin parfumin. Një gabim i vogël shkatërron reputacionin e një njeriu që mendohej të ishte i ditur. Zemra e të urtit është në drejtimin e duhur, por zemra e budallait është në drejtimin e gabuar (10:2). Një budalla e tregon marrëzinë e tij nga mënyra se si flet dhe si vepron (10:3).

Situata bëhet edhe më tragjike, kur mençuria u mungon njerëzve që janë në pushtet (10:4–7). Kur një pushtetar apo një qeveritar është i paarsyeshëm, ne nuk duhet të ndryshojmë pozicionin tonë. Por, duhet të jemi të duruar dhe të demonstrojmë një shpirt të qetë, sepse «gjakftohtësia i fashit fyerjet edhe kur janë të rënda» (10:4).

Një nga gabimet më të rënda që qeveritarët mund të bëjnë është që t'u japin të paafteve autoritet të madh, ndërkaq që u privojnë njerëzve të aftë pozitat me dinjitet që meritojnë. Ata që duhet të ishin shërbëtorë zënë pozita të larta, duke treguar natyrën e vërtetë të pushtetit dhe famës. Ata që duhet të jenë në pozita të larta jetojnë me përlulje, si shërbëtorë.

Marrëzia na udhëheq drejt dështimit. Meqenëse kudo ka rreziqe (10:8–11), budallai mund të shkatërrojë veten nga pakujdesia. Salomoni thotë se, kush hap një gropë, mund të bjerë vetë brenda. Ai që rrezon një mur apo një ndërtesë mund të kafshohet nga një gjarpër. Druvari dhe gurëpunuesi gjithashtu ballafaqohen me rreziqe. Po të jesh i ditur nuk vazhdon të presësh me një sopatë me teh të

pamprehur vetëm ngaqë mendon se një sopatë e mprehtë do të jetë më e rrezikshme. Njeriu me mend e mpreh sopatën, duke e ditur se, në këtë mënyrë, harxhon më pak energji për të mbaruar punën. Në qoftë se një magjistar mundohet të tregojë fuqinë e magjisë së tij mbi gjarpërin e tij dhe ti afrohesht ta prekësh atë gjarpër dhe, ndërkohë gjarpri të kafshon, fjalët ngushëlluese të magjistarit tashmë bëhen të kota. Ti duhet të ishe treguar aq i mençur sa të kuptoje se një gjarpër mbetet gjithmonë i rrezikshëm, bile edhe në duart e një magjistari. Dituria dhe urtësia duhet të na udhëheqin në çdo gjë.

Vëreni kontrastin e fjalëve dhe veprimeve të të diturit krahasuar me ato të budallait:

Fjalët e gojës të të urtit janë plot hir, por buzët e budallait e shkatërrojnë. Fillimi i ligjëratës së tij është budallallëk dhe fundi është marrëzi e dëmshme. Dhe sikur budallai t'i shumojë fjalët e tij, njeriu nuk di se çfarë do të ndodhë pas tij (10:12–14).

Fjalët e të urtit janë të hirshme. Ato kanë kuptim. Budallai bën gabime sa herë që hap gojën. Ai fillon me një ide të marrë dhe përfundon me ide të çmendura. Ai mendon se di gjithçka, duke përfshirë të ardhmen. Asnjëri nuk mund ta këshillojë apo ta paralajmërojë atë për ndonjë gjë.

Më tej, Salomoni pa se budallai lodhet menjëherë sa mendon për punën (10:15). Pak punë e lodh atë kaq shumë, sa ai nuk ka energji të mjaftueshme për të mësuar se ku po shkon.

Mençuria ka vlerë të madhe për të gjithë njerëzit, pavarësisht nëse janë mbretër apo punëtorë (10:16–20). Një vend që drejtohet nga një udhëheqës, i cili është shumë i papjekur për të qenë i mençur, është për të ardhur keq. Këshilltarët e tij dehen përpara dreke. Por, ajo tokë që ka si udhëheqës një djalë fisniku, këshilltarët e të cilit e mbarojnë punën përpara se të hanë dhe të pijnë, është e bekuar. Më pas ata hanë për të marrë fuqi dhe jo për t'u dehur.

Marrëzia e shkatërron «të zotin e vet» në shumë rrugë. Salomoni dha shembuj të ndryshëm të një sjelljeje të marrë dhe vetëshkatërruese te 10:18–20. Në fillim ai foli për dembelizmin. Njerëzit dembelë nuk mund të kujdesen as për shtëpitë e tyre. Për shkak të përtacisë trarët e shtëpisë rrëzohen dhe e gjithë shtëpia bie (10:18). Më tej, ai tha që budallenjtë shtrojnë bankete për t'u dëfryer (10:19). Ata pijnë verë për t'i shpëtuar realitetit dhe për t'u ndier për pak kohë të lumtur. Ata mendojnë se

paraja mund të blejë gjithçka. Dhe pastaj ai tha se nuk është mirë të mallkosh ata që janë në pushtet, madje as edhe kur jeni në dhomën tuaj të fjetjes. Një zog apo insekt i vogël mund të dëgjojë një mesazh të tillë dhe t'ua tregojë atë të tjerëve (10:20).

### **KONKLUZIONI**

Solomoni i përmblodhi këto mendime për t'iu

treguar gjithë njerëzve se sa e rëndësishme është të mendojmë gjithmonë me një mendje të kthjellët dhe të gëzojmë jetën që Perëndia na ka dhënë. Njerëzit e pakënaqur që gjithmonë rendin pas fitimit personal, nuk arrijnë kurrë të jenë me të vërtetë të lumtur. Ata kurrë nuk mund të kuptojnë se ç'është jeta vetë. Ata nuk e gëzojnë dhe nuk e vlerësojnë me të vërtetë jetën që Perëndia u ka falur.

Autor: *J. L. May*

Marrë nga studimi: "*Cili është kuptimi i jetës*"

© 2002, 2003 E VERTETA PER SOT

Të gjitha të drejtat të rezervuara